

## Titulli i lëndës: MJEKËSIA E PUNËS

Informatat themelore për lëndën	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Mjekësisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>MJEKËSIA E PUNËS</b>
<b>Niveli:</b>	Studime Themelore të Integruara
<b>Statusi i lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimit:</b>	Viti i 5-të   Semestri i 2-të
<b>Numri i orëve në javë:</b>	1 (L) + 2 (U)
<b>Kreditë ECTS:</b>	3 ECTS
<b>Koha/Vendi:</b>	Amfiteatri IKSHPK   Sipas orarit.
<b>Mësimdhënësi:</b>	Naim Jerliu
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<a href="mailto:naim.jerliu@uni-pr.edu">naim.jerliu@uni-pr.edu</a> ; Ndërtesa e IKSHPK, Kati 4.
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Lënda prezanton parimet themelore të punës dhe shëndetit dhe të mjekësisë së punës.</p> <p>Përshkruhet një skemë e gjerë për të njohur, diagnostikuar dhe menaxhuar një sërë problemesh shëndetësore të lidhura me punën. Për më tepër, kjo lëndë përqendrohet në promovimin dhe ruajtjen e shëndetit dhe aftësisë për punë të punëtorit dhe shoqërisë punuese.</p> <p>Lënda mbulon temat e mëposhtme: parimet themelore, ndikimin e punës në shëndet, efektin e shëndetit në punë, dhe promovimin e shëndetit. Ajo siguron informacion mbi këto tema dhe synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe njohuritë rreth rreziqeve në vendin e punës dhe të ndihmojë profesionistët e shëndetit për të mbrojtur shëndetin e punëtorëve dhe jetën e tyre. Gjithashtu, synohet të rritet interesimi i studentëve të mjekësisë në këtë fushë dhe të inkurajohen ata që të konsiderojnë mjekësinë e punës si një karrierë.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimet e kësaj lënde janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- t'u sigurojë studentëve të mjekësisë njohuri të mjaftueshme dhe aftësi dhe qëndrime të përshtatshme në trajtimin e çështjeve të lidhura me punën për t'i lejuar ata të funksionojnë në mënyrë efektive si profesionistë të shëndetit në një shoqëri në zhvillim dhe një botë të punës të ndryshueshme.</li><li>- të informojë dhe t'i bëjë studentët entuziastë për specializimin dhe fushën e mjekësisë së punës dhe t'i inkurajojë ata që ta konsiderojnë mjekësinë e punës si karrierë.</li><li>- të sigurojë mësimdhënie të mjekësisë së punës të harmonizuar me standardet në programet universitare të studimeve mjekësore nëpër vendet e BE-së.</li></ul>
<b>Rezultatet e pritshme të nxënies:</b>	Objektivat janë që deri në fund të këtij moduli studenti të jetë në gjendje të:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- kuptojë rëndësinë e punës dhe mjedisit më të gjerë për shëndetin dhe sëmundjen (Njohuri)</li> <li>- kuptojë ndikimin e shëndetit dhe sëmundjes në pjesëmarrjen në jetën e përditshme dhe në punë (Njohuri)</li> <li>- marrë një histori (anamnezë) të punës (profesionale) (Aftësi)</li> <li>- përshkruajë strukturën dhe rolin e shërbimeve të shëndetit në punë dhe mjekëve të punës (Njohuri)</li> <li>- vlerësojë perspektivat e ndryshme të kërkuara nga qasja e shëndetit në punë (Qëndrimet)</li> <li>- përshkruajë agentët të rëndësishëm (kimik, fizik, biologjik, psikosocial) dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e sëmundjeve në jetën profesionale (në punë) (Njohuri)</li> <li>- analizojë punën dhe vendet e punës nga perspektiva e mjekësisë së punës në lidhje me rrezikun për sëmundje dhe aftësinë e punës të reduktuar në përgjithësi, por edhe për individët me dobësi (vulnerabilitet) të veçantë (Njohuri, aftësi)</li> <li>- përdorë burime të mëtejshme dhe të dijë se ku të kërkojë ndihmë të specializuar (Njohuri, aftësi)</li> <li>- shpërndajë këshilla të përshtatshme tek pacientët e vet për aftësinë e kufizuar, rregullimin në vendin e punës dhe rehabilitimin në vendin e punës (Njohuri, aftësi)</li> <li>- pranojë përgjegjësinë ndaj parandalimit dhe raportimit të sëmundjes në punë dhe promovimit të shëndetit në punë (Qëndrimet)</li> <li>- ketë njohuri për aspektet ligjore dhe të menaxhojë problemet etike të çështjeve të lidhura me punën (Njohuritë, aftësitë)</li> </ul>
--	---

**Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatin e nxënies të studentit )**

Aktiviteti	Orët	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	1	15	15
Ushtrime / Punë Praktike	2	15	30
Punë terreni/ Vizita në vend pune	4	1	4
Test, seminar, prezentime	1	1	1
Detyrë shtëpie	1	15	15
Vetë-studim (bibliotekë ose shtëpi )			4
Përgatitja për provimin përfundimtar			4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi përfundimtar)			2
<b>Total</b>			<b>75/3 ECTS</b>
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	<i>Ligjërata, ushtrime praktike, punë projekti / seminar, detyra shtëpie individuale, vizitë në vendin e punës. Përfshihen materiale mësimore tradicionale dhe të vetë-drejtuar, të bazuara në internet.</i>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	· Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive në klasë: 20%		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>· Projekte / detyra individuale: 20%</li> <li>· Provimi përfundimtar: 60%</li> </ul> <p>Detyrat do të vlerësohen në bazë të përmbajtjes, organizimit dhe cilësisë së shkrimit.</p>
<b>Literatura primare:</b>	<p>Naim Jerliu. <b>Mjekësia e punës: Konceptet themelore</b> (Përmbledhje ligjëratash), Prishtinë, 2022</p> <p>Joseph LaDou, Robert Harrison. <b>Current Occupational &amp; Environmental Medicine</b>. 6th Edition, McGraw Hill, 2021</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p><i>Burime tekstesh të tjera</i></p> <p>Tee L. Guidotti M.D. M.P.H. The Handbook of Occupational and Environmental Medicine. 2<sup>nd</sup> edition. ABC-CLIO, 2020</p> <p>Finlay Dick, Julia Smedley, Steven Sadhra (Ed.) Oxford Handbook of Occupational Health. 2<sup>nd</sup> Edition, OUP Oxford, 2013</p> <p>Raymond Agius, Anthony Seaton. Practical Occupational Medicine. 2<sup>nd</sup> Ed. Hodder Education, 2005</p> <p>David Snashall, Dipti Patel (Ed.). ABC of Occupational and Environmental Medicine. 3rd Edition, Wiley, 2012</p> <p>David Soo Quee Koh, Ken Takahashi (Ed). Textbook Of Occupational Medicine Practice (3rd Edition). World Scientific Publishing Company. 2011</p> <p>Principles, Practice, Populations, and Problem-Solving, 2nd Edition</p> <p>Harrington JM, Aw TC, Gardiner K. Pocket Consultant: Occupational Health – 5th Edition, Wiley-Blackwell, 2006</p> <p>Linda Rosenstock, Mark Cullen, Carl Brodken, and Carrie Redlich. Textbook of Clinical and Environmental Medicine, 2nd Edition, 2004.</p> <p>William N Rom and Steven B. Markowitz. Environmental &amp; Occupational Medicine, 4th Edition, 2007.</p> <p><i>Materiale mësimore të bazuara në internet</i></p> <p>European Module for Undergraduate Teaching of Occupational Medicine <a href="https://emutom.eu/">https://emutom.eu/</a></p> <p>Raymond Agius. Index of Educational Resources: Occupational and Environmental Medicine and Health <a href="http://agius.com/hew/resource/index.htm">http://agius.com/hew/resource/index.htm</a></p> <p>Dr. Tee Guidotti. Occupational and Environmental Medicine <a href="http://www.teeguidotti.com">www.teeguidotti.com</a></p>

	<p>International Labour Organization (ILO), Your health and safety at work (series).  <a href="http://www.ilo.org/safework/info/instr/WCMS_113080/lang--en/index.htm">http://www.ilo.org/safework/info/instr/WCMS_113080/lang--en/index.htm</a></p> <p>Workers' Health Education  <a href="https://webcommunities.hse.gov.uk/connect.ti/riskeducation/view?objectId=62665">https://webcommunities.hse.gov.uk/connect.ti/riskeducation/view?objectId=62665</a></p> <p><i>Veqëza</i></p> <p>The European Association of Schools of Occupational Medicine (EASOM) <a href="http://www.easom.org">http://www.easom.org</a></p> <p>European Agency for Safety and Health at Work  <a href="http://osha.europa.eu/en/about">http://osha.europa.eu/en/about</a></p> <p>International Labour Organization (ILO)  <a href="http://www.ilo.org">www.ilo.org</a></p> <p>WHO. Occupational health  <a href="https://www.who.int/health-topics/occupational-health">https://www.who.int/health-topics/occupational-health</a></p> <p>The International Commission on Occupational Health (ICOH)  <a href="http://www.icohweb.org/site/homepage.asp">http://www.icohweb.org/site/homepage.asp</a></p> <p>Occupational health and safety.  <a href="https://ohsonline.com/Home.aspx">https://ohsonline.com/Home.aspx</a></p>
--	---

### Plani i hartuar mësimor

Java	Titulli i temës / ligjëratës
<b>Java 1:</b>	<p><b>Hyrje e përgjithshme për punën dhe shëndetin</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimet</li> <li>- Rëndësia e mjekësisë së punës</li> <li>- Marrëdhëniet midis punës dhe shëndetit</li> <li>- Tregu evropian / kosovar i punës</li> </ul>
<b>Java 2:</b>	<p><b>Puna dhe shëndeti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shëndeti dhe siguria në punë - Legjislacioni Evropian</li> <li>- Shëndeti dhe siguria në punë - Legjislacioni i Kosovës</li> <li>- Struktura dhe roli i shërbimeve shëndetësore në punë dhe detyrat e mjekëve të punës</li> </ul>
<b>Java 3 :</b>	<p><b>Puna dhe shëndeti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shtrirja e problemit: aksidentet, sëmundjet profesionale, mungesat në punë</li> <li>- Pyetjet kryesore për të ardhmen: PARP (WARP)</li> <li>- Marrja e një historie (anamneze) profesionale (të punës)</li> <li>- Etika</li> </ul>

<b>Java 4:</b>	<p><b>Efeksi i punës në shëndet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi</li> <li>- Agjentë toksikologjikë dhe kimikatet</li> </ul> <p>Përkufizimet dhe konceptet themelore, Burimet e rrezikut, rrugët e ekspozimit, hyrja / thithja, metabolizmi, vlerësimi i ekspozimit, monitorimin biologjik dhe i ambientit</p> <p>Toksikologjia në punë e fibrave minerale, metaleve, gazrave, asfiksuesve, irituesve, tretësve organikë</p> <p>Parandalimi</p>
<b>Java 5:</b>	<p><b>Efeksi i punës në shëndet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Agjentët biologjikë</li> </ul> <p>Përkufizimet, profesionet me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë</p> <p>Përmbledhje e rreziqeve kryesore biologjike dhe efekteve të tyre mbi njerëzit</p> <p>Parandalimi</p>
<b>Java 6 :</b>	<p><b>Efeksi i punës në shëndet</b></p> <p>Siguria dhe shëndeti në punë në emergjencat e shëndetit publik</p> <p>Masat e shëndetit publik dhe sociale në vendin e punës në kontekstin e emergjencave të shëndetit publik</p> <p>Parandalimi, identifikimi dhe menaxhimi i infeksionit të punonjësit shëndetësor në kontekst të emergjencave shëndetësore publike</p>
<b>Java 7:</b>	<p><b>Efeksi i punës në shëndet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Agjentët fizikë</li> </ul> <p><u>Zhurma:</u> Pasqyrë e fizikës së zërit dhe njësitë e matjes, fiziologjia bazë e veshit dhe efektet e zhurmës.</p>
<b>Java 8:</b>	<p><b>Efeksi i punës në shëndet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Agjentët fizikë</li> </ul> <p><u>Vibrimi:</u> Përmbledhje e fizikës së dridhjeve dhe efektet e saj shëndetësore në gjithë trupin dhe lokalisht.</p> <p><u>Klima:</u> Hyrje në përgjigjet e njeriut ndaj mjedisit termik dhe mënyrat për ta vlerësuar atë.</p> <p><u>Rrezatimi:</u> Hyrje në spektrin elektromagnetik dhe brezat e ndryshëm të rrezatimit jo-dhe jonizues.</p>
<b>Java 9:</b>	<p><b>Efeksi i punës në shëndet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fizika (Ergonomia)</li> </ul> <p>Kërkesat fizike</p> <p>Dhimbja jospesifikë e mesit (belit)</p> <p>Këshillimi i punëtorit dhe parandalimi</p>
<b>Java 10:</b>	<p><b>Efeksi i punës në shëndet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Aspektet psikosociale / mendore</b></li> </ul> <p>Përkufizimet</p> <p>Çrregullime mendore të lidhura me Punën</p> <p>Faktorët e rrezikut psikosocial</p>
<b>Java 11 :</b>	<p><b>Efeksi i punës në shëndet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut në vendin e punës</li> <li>- Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë për mjekët në mjedisin klinik</li> </ul>

<b>Java 12 :</b>	<b>Efekti i shëndetit në punë (Fitness për punë)</b> - <i>Hyrje: ndikimi, pozitiv dhe negativ, i shëndetit në punë.</i> Pasojat e sëmundjes (kronike), modeli ICF, Arsytimi klinik dhe vendimmarrja Aktivitete që vlerësojnë aftësinë për punë dhe pjesëmarrjen, Ndërhyrjet dhe mbështetja aktive Parandalimi
<b>Java 13 :</b>	<b>Promovimi i shëndetit në vendin e punës</b> - Përkufizimet - Historiku - Modeli evropian i referimit për promovimin e shëndetit në vendin e punës
<b>Java 14 :</b>	<b>Promovimi i shëndetit në vendin e punës</b> Analiza e treguesve negativë të shëndetit në një mjedis konkret pune (incidenca e pushimit mjekësor, lëndimet e lidhura me punën dhe paaftësia) Formulimi i një propozimi për masat e duhura për të zvogëluar ose eliminuar treguesit negativë Diskutime të rasteve, seminare të bazuara në probleme dhe vizita studimore
<b>Java 15 :</b>	Vlerësimi dhe diskutimi i përgjithshëm i lëndës dhe detyrave gjatë semestrit dhe përgatitja për provimin përfundimtar

### **Politikat Akadematike dhe Kodi i Sjelljes**

*Telefonat mobil / të mençur dhe pajisje të tjera elektronike duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos shihen gjatë kohës së mësimin.*

*Laptopët dhe kompjuterët tabletë janë të lejuar vetëm për përdorim në heshtje; ndalohen aktivitetet e tjera të tilla si kontrollimi i postës elektronike personale ose shfletimi i internetit, përderisa kjo nuk kërkohet si pjesë e aktivitetit mësimor dhe detyrave në klasë.*